



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK MALLAKASTËR

Nr. 2434/11 prot.

Ballsh më 21.05.2025

Lënda: Njoftim për zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit të Bashkisë Mallakastër.

- ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALLAKASTËR

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, shkronja “a”, në mbështetje të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak, dhe mbledhjes së mbajtur nga kryesia e këshillit, njoftoheni se mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Mallakastër do të mbahet në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit pranë Bashkisë ditën e **Mërkurë, datë 28 .05.2025, ora 14:00**, me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes më datë 29.04.2025.
3. **Projektvendim Nr.18:** Për miratimin e listës për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fondin deri në 6%.
4. **Projektvendim Nr.16:** Për një ndryshim të Vendimit Nr.56, datë 20.01.2021 “Për kategorizimin e niveleve të përfaqësimit të nxënësve në olimpiadat rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, në maturën shtetërore, çmime të tjera dhe përcaktimi i masës së shpërblimit të tyre”.
5. **Projektvendim Nr.17:** Për miratimin e marrëveshjes së investimit ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Mallakastër me objekt “Përmirësimi i transportit lokal dhe urban me ndërhyrje në ura dhe nyje lidhëse, ura Lumarë, Bashkia Mallakastër”.
6. **Projektvendim Nr.19:** Për dhënien në përdorim, për një afat 10-vjeçar, të sipërfaqes pyjore prej 0.95 ha, për qellime pushimi, argëtimi dhe për veprimtari turistike.
7. **Projektvendim Nr.20:** Për miratimin e financimit të ndarë në dy vite të projektit “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi, Ballsh””.
8. **Projektvendim Nr.21:** Për rishpërndarje të fondeve buxhetore për vitin 2025.

Mbledhja e komisioneve: për pikën 3,4,7,8 Komisioni i Ekonomisë dhe për pikat 5, 6 Komisioni Juridik.

KRYETAR KËSHILLI

Nexhmi Sulaj

